



Prishtinë: 14.01.2008
Kodi i ZRrE-së: D_083_2008
Nr. i Referencës: ERO/CPD_R_62_12_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dispozitat sipas Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
4. Ankesën e konsumatorit në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE me datë 11.10.2007 e numër regjistrimi 123/10 2007;
5. Njoftimi për shkyçje me datë 04.06.2007
6. Urdhëresa për shkyçje me datë 27.09.2007;
7. Përgjigjen e KEK Sh.A të datës 11.10.2007 e me numër reference DPR – CO1 – 11 lidhur me kalkulimin e dënimit për shkyçje;
8. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2008 morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Vahide Mala (konsumator komercial – 7/01, shifra e konsumatorit DPR - 90022203), për arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij Vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij me datë 28.09.2007 ka kërkuar që të hiqet gjoba për shkyçje pasi që KEK Sh.A e ka shkyçur nga rrjeti pa paralajmërim.
2. Me datë 11.10.2007 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumator iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar konsumatorin në arsyetimin se me datë 27.09.2007 për shkak të një borxhi prej 374.70 € është shkyç nga rrjeti elektrik konsumatori me ç’rast edhe është ngarkuar me gjobë prej 100.00 € plus TVSh-ja pra e gjitha prej 115.00 €. KEK Sh.A e ka njoftuar konsumatorin edhe për të drejtat e tij për të apeluar përgjigjen e tyre në Zyrën e Rregullatorit për Energji.
3. Konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 11.10.2007 në DMK të ZRrE-së lidhur me gjobën e shkyçjes që KEK SH.A e ka ngarkuar në vlerë prej 115.00 €.

4. Konsumatori në kërkesën e tij ka kërkuar që t'i hiqet gjoba e shkyçjes që KEK Sh.A e ka ngarkuar pasi që KEK Sh.A e ka shkyçur pa paralajmërim.
5. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë të dokumentacioneve të ofruara nga KEK Sh.A dhe nga konsumatori, ka propozuar Bordit të ZRrE-së që të refuzojë ankesën e konsumatorit me nr. 123/10 2007 për arsye si në vazhdim:
 - 5.1 Me datë 04.06.2007 KEK Sh.A e ka njoftuar konsumatorin e lartpërmendur me anë të Njoftimit për Shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK Sh.A, në bazë të nenit 16.1 a) të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ishte 409.15 €. Njoftimi për shkyçje e ka ngarkuar konsumatorin (borxhin e përgjithshëm) në shumë prej 10.00 € plus TVSH, pra e gjitha prej 11.50 €.
 - 5.2 Me datë 26.09.2007 ekipi i autorizuar i KEK Sh.A i Distriktit të Prishtinës ka dalë në vend të ngjarjes me çka kanë përpiluar Procesverbalin nr. 027039 dhe kanë konstatuar këtë gjendje: *“Konsumatori është shkyç për borxh që ka ndaj KEK Sh.A, ku borxhi obligativ i konsumatorit është 366.51 €. Prezent ishte praktikantja dhe se një kopje i lihet konsumatorit, i bllobuar me nr. 10015949”*.
 - 5.3 Me datë 27.09.2007 punëtorët e KEK Sh.A në bazë të urdhëresës për shkyçje e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak të mospagimit të borxhit ndaj KEK-ut, bazuar në nenin 6.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, me çka ekipi i kontrollës kanë vendosur vulën (bllobën) me numër 10015949. Konsumatori është ngarkuar edhe me gjobë prej 100.00 € plus TVSH, pra e gjitha prej 115.00 € e cila gjobë i ipet në bazë të shtojcës së dhënë në Rregullin mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë.
 - 5.4 Pas kësaj konsumatori me datë 28.09.2007 iu është drejtuar KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë me një ankesë lidhur me shkyçjen.
 - 5.5 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumator me datë 11.10.2007 e me numër reference DPR – CO1 – 11 iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në dhe ku është theksuar: *“se me datë 27.09.2007 tek konsumatori për shkak të borxhit në shumë prej 374.70 € si obligim i kësaj dite është dhënë urdhëresa e ekipit të shkyçjes për shkyçjen e konsumatorit nga rrjeti elektrik dhe s'epo këtë ditë është ekzekutuar kjo urdhëresë ku në njehsor është vendosur vula me nr. 10015949 dhe se për këtë shërbim është kalkuluar shuma prej 100.00 € plus TVSH-ja pra e gjitha prej 115.00€ dhe se që nga kjo datë ky konsumatorë duhet të jetë i shkyçur edhe më tutje”*.
 - 5.6 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE me datë 27.11.2007 iu është drejtuar KEK Sh.A me një shpjegim shtesë lidhur me shkyçjen e konsumatorit që i ka ndodhur me datë 26.09.2007 sipas procesverbalit nr. 027039 të po asaj date dhe se në urdhëresën për shkyçje figuron data 27.09.2007.
 - 5.7 KEK Sh.A me datë 29.11.2007 iu është përgjigjur konsumatorit lidhur me shpjegimin shtesë rreth shkyçjes. KEK Sh.A në përgjigjen e tyre kanë theksuar se: *“me datë 26.09.2007 tek konsumatori i lartcekur për shkak të borxhit në shumë prej 374.70 € si obligim i kësaj dite është dhënë urdhëresa për shkyçje*

për shkyçjen e konsumatorit nga rrjeti elektrik ku në njehsor është vendosur blomba me nr. 10015949 dhe për shërbim këtë shërbim është kalkuluar shuma prej 100.00 € plus TVSh, pra e gjitha prej 115.00 € dhe se nga kjo datë konsumatori duhet të jetë i shkyçur. Arsyeja pse në urdhëresë për (shërbimi i shkyçjes) është regjistruar data 27.09.2007 është sepse me datë 26.09.2007 për shkaqe teknike nuk kemi mundur ta regjistrojmë (shërbimin e shkyçjes) sipas urdhëresës së kryer por një ditë më vonë pra me datë 27.09.2007”

- 5.8 Në kartelën e konsumatorit (transaksionet e konsumatorit) shihet se konsumatori nuk e ka bërë pagesën e energjisë elektrike siç është specifikuar në njoftimin për shkyçje, por që pas njoftimit për shkyçje nga KEK Sh.A konsumatori i lartpërmendur ka bërë një pagesë prej 76.00 € me datë 03.09.2007, mirëpo që nuk e ka paguar në tërësi borxhin ndaj KEK Sh.A dhe se për këtë KEK Sh.A edhe e ka shkyçur konsumatorin.
- 5.9 KEK Sh.A ka zbatuar të gjitha procedurat e parapara sipas Rregullit për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, dmth. fillimisht e ka njoftuar konsumatorin për borxhin që konsumatori ka ndaj KEK Sh.A dhe pas kësaj pasi nuk janë kryer të gjitha obligimet ndaj KEK Sh.A është shkyçur nga rrjeti
- 5.10 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve i ZRrE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK Sh.A dhënë konsumatorit, analizimin e dëshmimeve të paraqitura dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, konstaton se KEK Sh.A ka zbatuar të gjitha procedurat e parapara në Rregullin mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, andaj duke u bazuar në atë se çka u tha më sipër Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE refuzon ankesën e konsumatorit si të pabazë.
6. Më 14.01.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **ta refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 5 të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Bordit të ZRrE-së

Anëtarët e Bordit:
